



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0923

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Internat Security Association” SH.P.K. kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “Komuna e Klines” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik I objektit të QKMF-se, QPS, SHPPM si dhe I Palestres Adem Jashari Kline” me numër të prokurimit:634-25-6834-2-1-1, me 05/11/2025, mori:

Vendim

1.Hedhet si e palejuar, ankesa e “Internat Security Association” SH.P.K. me nr. të protokollit 2025/0923, e datës 18/09/2025, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik I objektit të QKMF-se, QPS, SHPPM si dhe I Palestres Adem Jashari Kline”, me numër të prokurimit 634-25-6834-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Klines”

2.Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 05.08.2025, “Komuna e Klines” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik I objektit të QKMF-se, QPS, SHPPM si dhe I Palestres Adem Jashari Kline” me numër të prokurimit: 634-25-6834-2-1-1. Ndërsa me datën 04.09.2025 AK ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “KSF Major” SH.A. në shumën prej 214,099.20 Euro.

Me 07.09.2025 OE “Internat Security Association” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18.09.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Internat Security Association” SH.P.K. me nr. 2025/0923 lidhur me aktivitetin “Sigurimi fizik I objektit të QKMF-se, QPS, SHPPM si dhe I Palestres Adem Jashari Kline” me numër të prokurimit: 634-25-6834-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Internat Security Association” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

1. Autoriteti kontraktues Kuvendi Komunal i Klinës (tutje referuar si AK), me date 06.08.2025 ka shpallur njoftimin për kontratë në lidhje me aktivitetin e prokurimit me titull: Sigurim fizik të objekteve të APK-së, me numër të prokurimit 634-25-6834-2-1-1.
2. Njoftimi për kontratë është bërë në platformën e prokurimit elektronik (e-prokurimi).
3. Operatori ekonomik International Security Association SH.P.K., përmes platformës së prokurimit elektronik ka shkarkuar dosjen e tenderit me numër dhe titull të specifikuar si më lartë (tutje referuar si DT).
4. Një ndër kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit të shpallur nga AK ka qenë edhe kriteri i pagës për punëtor.

Në dosjen e tenderit Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 & 9.2 e dosjës Kapaciteti teknik dhe profesional, AK ka karkuar: Citoj: Kërkesat nga Neni 69 i LPP Stafi 1. Te punësuarit nuk duhet të kenë pagë me të vogël se 435.00 Euro bruto për muaj. Dëshmi-Deklarate që paga nuk do të jetë me e vogël se 435. 00 euro bruto.” Mbarim citati.

Poashtu në dosje të tenderit ANEKSI 1. Specifikimet teknike të detyrueshmë, AK ka përcaktuar Numrin e pikave të punëtorëve të sigurimit dhe orarin e punëtorëve të sigurimit për secilën pikë, si dhe numrin e punëtorëve.

Poashtu në të njëjtin dokument AK ka kërkuar që të respektohet Ligji i Punës.

Kërkesë e AK është citoj: Shenim: orët kujdestarisë dhe orët në festat zyrtare të parashihen sipas ligjit të punës” mbarim citati.

- Provë: Dosja e tenderit.

5. OE Internat Security Association, duke u bazuar në specifikat e dosjës së tenderit, kriteret e kërkuara nga AK në dosje të tenderit, respektivisht në FDT, pika 9.1&9.1 e dosjës si dhe duke u bazuar në ANEKSIN 1. Specifikimet teknike të detyrueshme, ka përpiluar ofertën financiare për të ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit.

Ofertës financiare i ka bashkëngjitur poashtu edhe analizën financiare e cila e vërteton se çmimi i ofertuar është çmim i bazuar në kushtet e kërkuara në dosje të tenderit dhe kërkesat për respektimin e Ligjit të Punës.

6. AK përmes njoftimit së datës 04.09.2025, ka shpërblyer me kontratë OE “KSF Major” SH.A., i cili ka ofertuar me një çmim prej 214,099.20 €, ndërsa OE Ankues e ka shpalur të pa suksesshëm me pretendimin se nuk ka qenë tenderi me çmimin më të ultë në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

7. OE Ankues, brenda afatit ligjor me datë 07.09.2025, në pajtim me Nenin 108/A par.1 nënpar. 3.2., ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndaj Vendimit të AK, mirëpo e njëjta kërkesë është refuzuar si e papabazuar.

8. Për shkaqet që do ti theksojmë më poshtë këtë Ankesë, OE Ankues konsideron se, AK me rastin e marrjes së këtij vendimit për shpërblim me kontratë dhe vendimit për refuzim të ankesës së OE Ankues ka bërë shkelje të:

1.1. Nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim / Jo – diskriminimi),

1.2. Neni 59 par.3 dhe 4 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve),

1.3. Neni 60 i LPP-së (Kriteret për Dhënien e Kontratës)

1.4. Neni 61, par. 2 i LPP-së (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët)

1.5. Nenin 41.5. pika (b) dhe Nenin 41.8. pika (ii) të RRUOPP-së,

1.6. E të gjitha këto shkelje të dispozitave të theksuara më lartë në mënyrë direkte janë të ndërlidhura dhe paraqesin shkelje të Nenit 6 të LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti).

1.7. Dispozitat Ligjore të Ligjit të Punës Ligji Nr. 03/L-212

II. Lidhur me shkeljet e dispozitave të LPP-së

10. AK me rastin e shpërblimit me kontratë të OE fitues, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, për shkak se OE fitues është dashur të shpallet i papërgjegjshëm sepse oferta e tij nuk ka qenë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen të tenderit, e që në rastin konkret vendimi për të shpallur fitues një OE të papërgjegjshëm përmban shkelje të dispozitave të LPP-së dhe RRUOPP-së.

11. OE fitues “KSF MAJOR SH.A” është dashur që të shpallet si i papërgjegjshëm nga ana e AK-së, për shkak se:

? Kalkulimi i pagës, nuk është bërë duke i'u përbajtur kërkesave të parashtruara në njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit (FDT pika 9.1&9.2 e dosjës ku është caktuar niveli i pagës për një punëtor të sigurimit në vlerën prej 435.00 euro bruto poashtu në ANEKSIN 1. Specifikimet

teknike te detyrueshme, AK ka kerkuar qe edhe te respektohet ligji i punes per orët e kujdestarisë dhe festat zyrtare;

? Poashtu çmimi i ofruar nga OE i shpallur fitues, është kundërshtim me Nenin 55, 56, 57, 58 dhe 59 të Ligjit të Punës Ligji Nr. 03/L-212, si dhe

II.1. Lidhur me kalkulimin e pagës bruto në kundërshtim me njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe sqarimet e AK-së

12. OE fitues, nuk i është përmbajtur kërkesave të parashtruara në njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit, sa i përket kërkesës së kalkulimit të pagës bruto dhe respektimin e Ligjit të Punës bazuar në kriteret e kërkuara në dosje të tenderit.

13. OE ankues International Security Association, ju ka përmbajtur në përpikëri kriterëve të përcaktuara në dosje të tenderit pika 9.1 & 9.2 e FDT si dhe ANEKSI 1 i dosjës.

Bazuar në këto kërkesa në kemi llogaritur çmimin e ofertës, poashtu duke e respektuar Ligjin e Punës, ku vet AK ka kërkuar që të respektohen dispozitat Ligjore të Ligjit të punës.

14. Edhe përkundër faktit se AK në përgjigjet në pyetje, ka kerkuar respektim te dispozitave ligjore, kete kriter nuk e ka respektuar gjate vleresimit te ofertave, por keni rekomanduar per kontrate OE i cili ka ofruar çmimin me te cilin nuk mundet ne asnje menyre ti mbuloj kerkesat sipas ligjit.

Ndërsa me ofertën e paraqitur nga OE fitues pa asnjë mëdyshje vërtetohet se oferta e tillë nuk është në përputhje me këtë kërkesë, sepse çmimi i ofertuar në raport me orët e punës të parashikuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit nuk është real dhe i kalkuluar në bazë të kërkesave të parashtruara nga AK.

13. Sikur OE fitues të kishte respektuar kërkesat në lidhje me pagën bruto prej 435.00 € për një punëtor të sigurimit, si dhe sikur ti kishte marrur perbazë edhe kërkesat e Ligjit të Punës për llogaritjen e pagës, sipas kërkesës së AK ne Aneksin 1, të dosjës së tenderit, si orët e natës plus 30%, orët e vikendit dhe festave +50%, poashtu edhe llogaritjen e pagesës së pushimit vjetor, kriteret këto të cilat janë bazike dhe obligative për secilin biznes, atëherë oferta e tij nuk do të ishte në asnjë rrethanë kaq e ultë sepse një gjë e tillë është tërësisht e

pamundur nëse do të respektoheshin kërkesat e parashtruara sa i përket pagës bruto.

14. Për të vërtetuar deklaratën tonë, ne kemi bashkëngjitur në ofertë edhe tabelen për llogaritjen e çmimit, e cila e tregon sakte se sa mund të jete çmimi minimal bazuar ne kerkesat e tenderit te shpallura nga AK dhe kerkesat e Ligjit te Punes.

- Provë – tabela e llogaritjes se cmimit dhe pages per punetor.

15. Dekalorata e AK në vendimin e datës 09.09.2025, e cila ka theksuar se nuk ka kërkuar analizë financiare është në kundërshtim me vet kërkesat që AK i ka përcaktuar në dosje të tenderit, sepse AK në dosje të tenderit FDT pika 9.1 & 9.2 ka kërkuar dëshmi të cilën OE ankues e ka paraqitur në firmë të tabelës, prandaj kjo është një dëshmi e dyfishtë e cila vërteton kërkesën e AK për nivelin e pagës minimale bruto si dhe kërkesën tjetër në

ANEKS 1, ku kërtej pagës AK ka kërkuar që të respektohet Ligji i Punës.

16. Me kete veprim, AK ka shkelur Ligjin e Prokurimit publik, respektivisht:

Neni 7 Barazia ne trajtim/Jo diskriminimi; për faktin se kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit, kanë qene kërkesa të cilat kanë përcaktuar pagën minimale bruto, por njëkohësisht është kërkuar respektimi i dispozitave ligjore te ligjit te punës, ndërsa vlerësimi I ofertave është bërë në kundërshtim me kërkesat e vet AK. Në këtë formë janë lajthitur OE.

Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahassimi i Tendereve: par 4 i LPP-së, sepse në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me këtë nen, ka shpallur fitues OE i cili nuk I plotëson kriteret sipas dosjës së tenderit. Si dhe ka shpallur të pasuksesshëm OE INTERNAT SECURITY ASSOCIATION, edhe pse i plotëson kriteret sipas ligjit.

Neni 60 Kriteret per dhenien e kontrates; edhe pse AK ka përcaktuar kriteret të kontratës pagën minimale bruto prej 435 euro si dhe respektimin e ligjit, përfshirë edhe Ligjin e punës, ndërsa vet AK, nuk e ka respektuar këtë kriter, por ka rekomanduar per dhenie te kontrates OE, i cili nuk i plotëson as për se afërmi këto kriteret.

Neni 61 Tenderte Jo-Normalisht të Ulët: AK nuk e ka vlerësuar ofertën financiare të OE të shpallur fitues në frymën e Nenit 61, ku bazuar në këtë Nen, OE i shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret sipas dosjes së tenderit dhe dispozitave ligjore, prandaj AK është dashtë që OE e shpallur fitues ta eliminoj mbi bazën e këtij Neni, si dhe ofertat tojera të cilat me ofertën financiare nuk i plotësojnë kriteret dhe nuk i respektojnë dispozitat ligjore të Ligjit të punës.

15. Andaj AK me rastin e shpërblimit me kontratë të OE fitues, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, për shkak se OE fitues është dashur të shpallet i përgjegjshëm në kuptim të Nenit 59 par.4 të LPP-së lidhur me Nenin 41.4. pika (b) të RRUOPP-së, sepse oferta e tij nuk ka qenë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe dosjen të tenderit.

Neni 59 par.4 i LPP-së thotë: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Neni 41.4. pika (b) e RRUOPP-së thotë: Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur është në pajtueshmëri me termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit.

II.2. Lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe Vendimit të Qeverisë së Kosovës për pagën minimale në nivel vendi

16. Po ashtu, AK me rastin e shpalljes fitues të OE “KSF Major SH.A.”, ka nuk ka marrur për bazë Ligjin e Punës në Republikën e Kosovës, i cili është obligativ për të gjitha bizneset dhe duhet të respektohet në përpikëri:

Neni 57. Paga Minimale, par 1 dhe 2 . i Ligjit të Punës thotë:

1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuar ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.

2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:

2.1. 20 % në orë për kujdestari;

2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;

2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;

2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe

2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.

3. Paga minimale përcaktohet në bazë të orëve të punës, për periudhën një (1) vjeçare, e cila publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

4. Paga minimale mund të përcaktohet me marrëveshje në nivel kombëtar, në nivel dege dhe në nivel të ndërmarrjes, por që nuk duhet të jetë më e ulët se paga minimale e paraparë në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 58. Kompensimi i pagës, par 1 i Ligjit të Punës thotë:

1. I punësuari ka të drejtë për kompensim në pagë, në rastet si në vijim:

1.1. gjatë ditëve të festave në të cilat nuk punohet;

1.2. gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor;

1.3. gjatë aftësimit dhe përsosjes profesionale për të cilën është dërguar, dhe

1.4. gjatë ushtrimit të funksioneve publike për të cilat nuk paguhet.

Neni 32. Kompensimi i pushimit vjetor, par 1 i Ligjit të Punës thotë:

I punësuari gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar.

Neni 59. Kompensimi i pushimit mjekësor, par 1 i Ligjit të Punës thotë:

I punësuari në rast të sëmundjes ka të drejtë në pushim mjekësor të rregullt mbi bazën, deri në njëzet (20) ditë pune brenda një (1) viti me kompensim prej 100 % të pagës.

Andaj nga gjendja faktike të cilën e kemi pasqyruar në këtë ankesë, lehtësisht mund të kuptohet se AK ka shpërblyer me kontratë OE i cili nuk i plotëson as për së afërmi kushtet dhe kriteret ne përcaktuar në dosje të tenderit.

III. PËRFUNDIM

I tërheqim vëmendjen OSHP-së se, AK me rastin e vlerësimit të ofertave të OE të cilët kanë konkuruar në këtë proces të prokurimit, ku ka marrë vendim për shpërblyerje me kontratë OE fitues me çmimin më të ulët, pas asnjë kriter dhe pa asnjë bazë ligjore.

Në të njëjtën kohë ka marrë vendim ta shpallë të pasusesshëm e OE Internat Security Association, me arsyetimin se çmimi i ofruar nuk është çmimi më i lirë, duke mos e marrur

përbazë se oferta jonë është në prapthje me Kërkesat sipas Dosjes së tenderit, Sqarimin e dhënë nga AK në përgjigjet e pyetjeve; në prapthje me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës si dhe Vendimit të Qeverisë së Kosovës për pagën minimale.

Poashtu e ka hedhur poshtë Kërkesën për Rishqyrtim, të cilën OE Internat Security Asociation e ka parashtruar pranë AK, duke u bazuar në fakte dhe prova të bazuara dhe të besueshme. AK ka bërë shkelje për shkak se OE fitues dhe OE ankues nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë. AK është dashur të eliminojë OE të cilët me ofertat e tyre financiare nuk i plotësojnë kërkesët të cilat i kemi thekuar më lartë, konform dopsjes së tenderit dhe dispozitave ligjore.

Duke marrë parasysh të gjitha këto fakte të argumentuara më lartë në këtë ankesë, konsiderojmë se, AK ka marrë vendim të kundërligjshëm për shkak se:

AK ka bërë trajtimin diskriminues dhe të pabarabartë të operatorëve ekonomik;

AK ka shpërblyer me kontratë një OE të papërgjegjshëm, sepse oferta e tij nuk ka qenë në përputhshmëri me kërkesat e përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit sa i përket kalkulimit të pagës sipas nivelit të pagës të përcaktuar nga AK në dosje të tenderit si dhe kërkesës për respektimin e ligjit të punës.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22/09/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0923/25, ndërsa me datë 27/09/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0923 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të hedhet poshtë si e palejuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues nuk është deklaruar, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Internat Security Association” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0923 ka vlerësuar si në vijim:

Për këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar gjithsej (7) shtatë OE. AK ka vlerësuar ofertat e dorëzuara dhe ka publikuar njoftimin mbi vendimin e Ak-se, duke rekomanduar për kontratë OE me çmimin më të lirë nga ofertat e pranuar. Të gjithë OE-të tjerë janë shpallur ofertues të pasuksesshëm.

OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim me pretendimin se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e FDT-së. Ky OE, sipas renditjes së OE-ve të përgjegjshëm dhe te pasuksesshem, është i gjashti me radhë sipas çmimit të ofertuar.

Në kërkesën për rishqyrtim, OE ankues është ankuar vetëm ndaj ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, pa paraqitur pretendime lidhur me ofertat e OE-ve të tjerë të renditur para tij me çmime më të ulëta. AK, pas shqyrtimit të pretendimeve, ka konstatuar se ato janë të pabazuara dhe rrjedhimisht i ka refuzuar.

Më pas, OE ankues ka ushtruar ankesë në OSHP, duke përsëritur të njëjtat pretendime si në kërkesën për rishqyrtim, të cilat lidhen vetëm me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimor i OE ankues ka te beje me kerkesat teknike profesionale te cilat sipas kerkesave te FDT-se është kerkuar:

Kërkesat nga Neni 69 i LPP Stafi 1. Te punësuarit nuk duhet te kenë pagë me të vogël se 435.00 Euro bruto për muaj.

Deshmi- Deklarate qe paga nuk do të jetë me e vogel se 435. 00 euro bruto.

OE ankues pretendon se oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk ka qenë në përputhje me kërkesat e parashtruara në Njoftimin për Kontratë dhe në FDT, për shkak se kalkulimi i pagës nuk është bërë duke iu përmbajtur kërkesave të parashtruara në Njoftimin për Kontratë dhe në dosjen e tenderit, rrjedhimisht oferta e OE të rekomanduar nuk do të mund të mbulojë kërkesat për pagë sipas Ligjit të Punës.

Eksperti shqyrtues sqaron se, sipas kërkesave të FDT-së, me qëllim të përmbushjes së kërkesës për pagën minimale të përcaktuar, është kerkuar vlere prej 435.00 € dhe si dëshmi është paraparë vetëm paraqitja e një deklarate nga OE-të pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit. Gjatë ofertimit, pothuajse të gjithë ofertuesit kanë dorëzuar deklaratën konform kërkesave të FDT-së.

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues, se AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar nenin 7, 59, 60 dhe 61 të LPP-së si dhe nenin 41.5 të RRPP 002/2024, nuk është i qëndrueshëm. Kjo për faktin se, në bazë të kërkesave të FDT-së, nuk është paraparë që OE-të të paraqesin analizë financiare, por vetëm një deklaratë përmes së cilës ata pajtohen që paga minimale që do t'u paguhet stafit të angazhuar të jetë në vlerën e caktuar. Këtë kërkesë e kanë plotësuar të gjithë OE pjesëmarrës.

Eksperti shqyrtues gjithashtu vlerëson se pretendimet e OE ankues lidhur me shkeljen e dispozitave të Ligjit të Punës nga ana e AK-së, me rastin e përzgjedhjes së OE të rekomanduar për kontratë, nuk qëndrojnë. Përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë është bërë duke u bazuar në kërkesat e përcaktuara në FDT dhe duke u mbështetur në dispozitat e LPP-së, dhe si rrjedhojë vlerësohet se pretendimi nuk është i bazuar.

Çdo shkelje e mundshme që mund të rezultojë nga mosrespektimi i dispozitave të Ligjit të Punës nuk bie në kompetencë të AK-së apo të procedurave të prokurimit publik, por është përgjegjësi e Inspektoratit të Punës, si organ mbikëqyrës, për të siguruar që të gjithë AK-të dhe OE-të veprojnë në përputhje me Ligjin e Punës.

Eksperti shqyrtues pas administrimit të provave të ngarkuar në prokurim respektivisht, raportit të vlerësimit, njoftimit mbi vendimin e AK-se, kërkesën për rishqyrtim, si dhe ankesën e dorezuar në OSHP vlerëson se pretendimet ankimore të OE ankues nuk lidhen me faktin nëse interesi ekonomik i tij është dëmtuar.

Rrjedhimisht, parashtruesi i ankesës në këtë procedurë ankimore nuk mund të konsiderohet palë me interes në kuptim të paragrafit 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP-së, sipas të cilit “palë e interesuar” është personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit.

Kjo bazuar në faktin se OE ankues, në listën e ofertuesve të përgjegjshëm, renditet i gjashti në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, dhe është shpallur si i tillë edhe në njoftimin mbi vendimin e AK-se.

Përkundër kësaj, OE ankues e sulmon vetëm OE të rekomanduar, pa argumentuar se OE të tjerë, të renditur përpara tij, nuk janë të përgjegjshëm. Këta të fundit janë të përgjegjshëm/pasuksesshëm dhe ofrojnë çmime më të ulëta se OE ankues.

Si përfundim, duke marrë parasysh këto fakte, eksperti shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit ka vepruar në përputhje me FDT dhe se OE ankues, sipas nenit 4, par. 1.26 LPP, nuk ka argumentuar statusin e palës me interes.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave përkitazi me këtë procedurë të prokurimit, OSHP konsideron se ankesa e OE ankues e pranuar në OSHP me datën 18.09.2025 është e palejuar sepse lidhur me këtë aktivitet OE Ankues në ankesën e tij e atakon vetëm OE të rekomanduar për kontratë duke mos argumentuar dhe atakuar edhe 04 OE të tjerë vlerësuar si oferta të pasuksesshme, të cilët ishin me çmim me të lirë, dhe janë pajtuar me vendimin e AK-se ndërsa diferenca në mes të OE të rekomanduar me OE ankues është -38,789.34 Euro.

Nga të gjitha sqarimet e cekura si më lartë, hidhet si e pa lejuar ankesa e parashtruar e datës 18.09.2025 e OE “Internat Security Association” SH.P.K. me nr. të protokollit 2025/0923, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objektit të QKMF-se, QPS, SHPPM si dhe i Palestres Adem Jashari Kline”, me numër të prokurimit 634-25-6834-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Klines”, dhe konfirmuar në nenin 4, 1. 26 të ligjit, OE ankues konsiderohet si palë pa interes juridik për shkak sipas arsyesimit në vendim, prandaj Ankuesi nuk mund të arrijë të dëshmojë se ka statusin e palës së interesuar sipas dispozitës 4. 1.26 të LPP-së duke ju referuar njoftimit të OSHP-së data 09.02.2023.

Autoriteti kontraktues – “Komuna e Klines”, mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Sigurimi fizik i objektit të QKMF-se, QPS, SHPPM si dhe i Palestres Adem Jashari Kline”, me numër të prokurimit 634-25-6834-2-1-1, nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në këtë rast mban përgjegjësi për përzgjedhjen e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Duke qenë se OE ankues me rastin e parashtrimit të ankesës ka paguar tarifë, e njëjta konform nenit 31, par 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet OE ankues. I njëjti obligohet që kërkesën për kthim të mjeteve ta parashtrojë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve sipas nenit 31 par 6 të rregullores së cituar më lartë.

Paneli Shqyrtues konsideron se edhe ky vendim si secili vendim tjetër i nxjerrë nga OSHP posedojnë këshillën juridike dhe kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - "Internat Security Association"SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: